



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 10-111-01-28087-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date 19. 09. 2025

OBILIQ - OBILIČ - OBILIC

Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republik of Kosova
Komuna e Obiliqit/Opština Obilič/Municipality of Obiliq



Drejtoria e Arsimit

Bazuar në ,nenet 6 dhe 19 të Rregullores Për Ndarjen E Bursave, Kompensimin E Shpenzimeve Të Udhëtimit Dhe Aktivitet Jashtëshkollor, Nr.-I-104, të datës 31.08.2020, dhe kërkesën me nr.-X-10-111-01-27810 të datës 17.09.2025, Drejtoria e Arsimit më 19.09.2025 shpall:

KONKURS

(Për kompesimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës për vitin shkollor 2025-2026)

Për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës të Komunës së Obiliqit të këtyre kategorive:

1. Për nxënës nëse distanca e udhëtimit shtëpi-shkollë është së paku 3 kilometra
2. Për nxënës me nevoja të veçanta
3. Për nxënës, familjet e të cilëve janë raste sociale, në qoftë se në relacionet e udhëtimit të këtyre nxënësve është i organizuar udhëtimi publik apo privat.
4. Për nxënës të Komunës së Obiliqit në shkollat e mesme të larta, që vazhdojnë shkollimin në komunat tjera, por vetëm në drejtimet që nuk janë në shkollat e mesme të larta në Komunën e Obiliqit.

Dokumentet e nevojshme për të gjitha kategoritë :

- Vërtetimi nga shkolla që është nxënës i rregullt dhe për distancën shtëpi-shkollë
- Kopja e letërnjoftimi (në mungesë të letërnjoftimit të sjell certifikatën e lindjes),
- Për rastet nxënës me nevoja të veçanta arsimore, të sjellin edhe diagnozën e mjekut
- Për rastet sociale, të sjellin edhe vërtetimin nga Qendra për Punë Sociale në Obiliq.
- Konfirmimin bankar i nxënësit ose prindërit
- Letërnjoftimi i nxënësit ose prindërit

Sqarim: Letërnjoftimi dhe konfirmimi i bankës duhet të jenë vetëm të njërit prind

Komisioni për ndarjen e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit e ruan të drejtën, të verifikojë gjendjen faktike të kriterëve të kërkuara sipas konkursit për kandidatët që kanë aplikuar për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit.

Fletëkërkesat merren në Zyrën e pranimit të KK-së, ose në faqen zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në të njëjtën Zyrë. Afati i konkurimit është 15 ditë pune.

Drejtoresha: Fitore Hashani

